



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2021, mori këtë

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E OBELISKUT NË SHENJË MIRËNJOHJE PËR**  
**PROFESIONISTËT SHËNDETËSORË DHE NË NDERIM TË ATYRE QË KANË NDËRRUAR JETË**  
**NGA VIRUSI COVID-19**

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19 në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e këtij obelisku, është propozuar të jetë në hyrjen kryesore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, përkatësisht shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale, nr. 2723-0, ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë shoqërore, KK Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për caktimin e lokacionit të këtij obelisku.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

01-353/01-82495/21, më 12.05.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**

Agim Kuleta



## ARSYETIM

### I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderimi të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën, nr. ref. 296/2020, dt. 04.12.2020, drejtuar Kryetarit të Komunës nga Odat e Profesionistëve Shëndetësorë (Oda e Mjekëve, Oda e Stomatologëve, Oda e Farmacistëve, Oda e Infermierëve dhe Oda e Fizioterapeutëve) të Kosovës, për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur nga Odat e Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin e kërkuar për vendosjen e këtij obeliskut, i cili gjendet në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Zona Perëndim" i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për infrastrukturë rrugore.

Lokacioni i kërkuar/propozuar shtrihet në pjesë të parcelës kadastrale, nr. 2723-0, ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë shoqërore, KK Prishtinë.

Është propozuar që obelisku në fjalë të vendoset në hyrjen kryesore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës nga Odat e Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset obelisku është pjesë e infrastrukturës rrugore, përkatësisht sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së tij duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ambientit. Propozohet që të vendoset në madhësi, formë dhe material të përcaktuar sipas kërkesës së parashtruar (gjerësi 2.5 m dhe gjatësi 10 m).

#### **Bashkëngjitur:**

Ortofoto e lokacionit sipas Geoportal Kosova.

Ortofoto e lokacionit



